



ARGUMENTUM

news opinion analysis



**Shqipëria ndërpret
marrëdhëniet
diplomatike me Iranin**

- Fundi i një epoke për Britaninë!
Mbretëresha Elizabeth ndërron
jetë në moshën 96-vjeçare,

-Pse Ballkani i Hapur
nuk ngjit as me verë?

-Presidenti Putin shpall
mobilizim të pjesshëm në Rusi,
dhe anekson 4 rajone të Ukrainës

-Erdogan, conditions
otherwise Haram!

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online. Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji. Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe ko-

mente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexuesve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 JO VETËM LAJM

- Shqipëria ndërpret marrëdhëniet diplomatike me Iranin.

05 EDITORIAL

- Pse Ballkani i Hapur nuk ngjit as me verë?

09 INTERVISTA

- **EKSKLUZIVE/** Ambasadori i Kinës në Shqipëri Z. Zhou Ding: Kina e Shqipëria duhet të shikojnë nga historia për të ndërtuar të ardhmen.

11 JO VETËM LAJM

- MBRETËRESHA ELIZABETH ndërron jetë në moshën 96-vjeçare, duke i dhënë fund një epoke për Britaninë.

- Presidenti Putin shpall mobilizim të pjesshëm në Rusi, dhe anekson 4 rajone të Ukrainës.

- TASS përpiloi deklaratat kryesore të Putinit, të cilat i sjell në shqip Argumentum.al.

- Shqipëria dënon aneksimin nga Rusia për 4 rajonet e Ukrainës.

19 REALPOLITIK

- Britania elisabetiane! Fjalë, fjalë 77! Pa lidhje

dhe pa kuptim! Gjeopolitika fillon nga brenda!

21 REALPOLITIK

- Kryeministri Rama iu nënshtrohet kushteve të Erdogan... mbyll shkollat e Gylenit dhe blen dronë "Bayraktar" nga Turqia.

ENGLISH EDITION

25 EDITOR'S TAKE

- Will Berisha's pledge for 'autumn of protests' deliver?

26 IN FOCUS

- The Exhibition of Historical Sino-Albanian Photographs launched in Tirana.

27 TOP NEWS

- Albania cuts ties with Iran over cyberattack ordering its Embassy to leave within 24 hours.

- Queen Elizabeth dies at 96, ending an era for Britain.

29 REALPOLITIK

- Berlin is more than enough! Erdogan, conditions otherwise Haram! Good words but stones in the rafters! The dialogue is Vucic hostage!!

Shqipëria ndërpret marrëdhëniet diplomatike me Iranin



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama

Hetimi i thelluar na vuri në dispozicion prova të pakundërshtueshme, se agresioni kibernetik ndaj vendit tonë është orkestruar dhe sponsorizuar nga Republika Islamike e Iranit, e cila ka angazhuar katër grupe për sulmin ndaj Shqipërisë. Ndër to edhe një ndër grupet më famëkeqe të terrorizmit kibernetik ndërkombëtar, autor apo bashkëautor i sulmeve të mëparshme kibernetike mbi Izraelin, Arabinë Saudite, Jordaninë, Emiratet e Bashkuara, Kuvajtin dhe Qipron.

K

ryeministri Edi Rama ka kërkuar që stafi diplomatik i ambasadës së Republikës Islamike të Iranit të largohet brenda 24 orëve nga Shqipëria.

Këshilli i Ministrave, ka vendosur me efekt të menjëhershëm ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën Islamike të Iranit.

Kryeministri Edi Rama u shpreh sot në një videomesazh, lidhur me vendimin e qeverisë shqiptare, si kundërpërgjigje ndaj aktit të sulmit të rëndë kibernetik

ndaj infrastrukturës digjitale të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, se, “në 15 korrikun e shkuar vendi ynë u bë objekt i një sulmi të rëndë kibernetik, i cili kishte si objektiv shkatërrimin e infrastrukturës digjitale të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, paralizimin e shërbimeve publike, si edhe grabitjen e të dhënave dhe të komunikimeve elektronike nga sistemet qeveritare. Sulmi nuk ia arriti qëllimit. Krahasimisht me objektivat e agresorit, dëmet mund të konsiderohen të vogla. Sistemet u rivendosën të gjitha në punë dhe asgjë nuk u zhduk pa kthim”.

“Për javë të tëra u punua paralelisht, ditë-natë, qoftë për rivënien e të gjitha sistemeve në punë, qoftë për hetimin e thellë për gjetjen e agresorit. Në bashkëpunim me agjenci të specializuara partnere të anti-terrorit digjital, të cilat sollën në Tiranë skuadrat e tyre, u arrit të zbulohet fillimisht, pa asnjë hije dyshimi, se sulmi i 15 korrikut mbi Shqipërinë nuk ishte një operacion individësh apo grupesh të pavarura në botën e krimit të organizuar kibernetik, por një agresion shtetëror. Hetimi i thelluar na vuri në dispozicion prova të pakundërshtueshme, se agresioni kibernetik ndaj vendit tonë është orkestruar dhe sponsorizuar nga

Republika Islamike e Iranit, e cila ka angazhuar katër grupe për sulmin ndaj Shqipërisë. Ndër to edhe një ndër grupet më famëkeqe të terrorizmit kibernetik ndërkombëtar, autor apo bashkautor i sulmeve të mëparshme kibernetike mbi Izraelin, Arabinë Saudite, Jordaninë, Emiratet e Bashkuara, Kuvajtin dhe Qipron”, u shpreh Rama.

“Ne kemi informuar aleatët tanë strategjikë, vendet partnere të NATO-s dhe disa vende të tjera mike, me të cilat kemi ndarë edhe rezultatet e pakundërshtueshme të hetimit që provon burimin e agresionit ndaj vendit tonë”, deklaroi Rama.

FJALA E PLOTË E KRYEMINISTRIT RAMA

Në 15 korrikun e shkuar vendi ynë u bë objekt i një sulmi të rëndë kibernetik, i cili kishte si objektiv shkatërrimin e infrastrukturës digjitale të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si edhe grabitjen e të dhënave dhe të komunikimeve elektronike nga sistemet qeveritare.

Sulmi nuk ia arriti qëllimit. Krahasimisht me objektivat e agresorëve, dëmet mund të konsiderohen të vogla. Sistemet u rivunë të gjitha në punë dhe asgjë nuk u zhduk pa kthim.

Për javë të tëra u punua paralelisht, ditë-natë, qoftë për rivënien e të gjitha sistemeve në punë, qoftë për hetimin për gjetjen e agresorëve. Në bashkëpunim me agjensi të specializuara partnere të anti-terrorit digjital, të cilat sollën në Tiranë skuadrat e tyre, u arrit të zbulohet fillimisht, pa asnjë hije dyshimi, se sulmi i 15 korrikut mbi Shqipërinë nuk ishte një operacion individësh apo grupesh të pavarura në botën e krimit të organizuar kibernetik, po një agresion shtetëror.

Hetimi i thelluar na vuri në dis-

pozicion prova të pakundërshtueshme, se agresioni kibernetik ndaj vendit tonë është orkestruar dhe sponsorizuar nga Republika Islamike e Iranit, e cila ka angazhuar katër grupe për sulmin ndaj Shqipërisë. Ndër to edhe një ndër grupet më famëkeqe të terrorizmit kibernetik ndërkombëtar, autor apo bashkëautor i sulmeve të mëparshme kibernetike mbi Izraelin, Arabinë Saudite, Jordaninë, Emiratet e Bashkuara, Kuvajtin dhe Qipron.

Ne kemi informuar aleatët tanë strategjikë, vendet partnere të NATO-s dhe disa vende të tjera mike, me të cilat kemi ndarë edhe rezultatet e pakundërshtueshme të hetimit që provon burimin e agresionit ndaj vendit tonë.

Nisur nga sa më lart Këshilli i Ministrave, ka vendosur me efekt të menjëhershëm ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën Islamike të Iranit. Ky vendim i është bërë i ditur me notë zyrtare Ambasadës së Republikës Islamike të Iranit, të cilës i është kërkuar largimi brenda 24 orëve nga territori i Republikës

së Shqipërisë i të gjithë personelit diplomatik dhe tekniko-administrativ, përshfirë edhe atë të sigurisë.

Kjo masë ekstreme, aspak e deshiruar po krejtësisht e detyruar, është në proporcion të plotë me seriozitetin dhe rrezikshmerinë e sulmit kibernetik, i cili kërcënoi paralizimin e shërbimeve publike, fshirjen e sistemeve dhe grabitjen e të dhënave shtetërore, vjedhjen e komunikimeve elektronike brenda sistemit qeveritar dhe nxitjen e pasigurisë e të kaosit në vend.

Dështimi i këtij sulmi masiv mbi vendin tonë, falë rezistencës së sistemeve që kemi ngritur dhe ndihmës së grupeve speciale që na u bashkuan në këtë luftë, nuk është fundi i kërcënimit kibernetik, po thjesht prova se tanimë edhe Shqipëria ka hyrë falë zhvillimit digjital në hartën e gjerë të luftës për sigurinë kibernetike.

Por lajmi i mirë është se ne e dimë se çfarë duhet të bëjmë e si duhet ta bëjmë për të mos na prekur dot askush, ashtu siç dimë edhe se do t'i bëjmë siç duhet gjërat e duhura, sepse kemi partnerët e duhur.

Pse Ballkani i Hapur nuk ngjitet as me verë?



NGA DR. JORGJI KOTE

U Kjo pyetje e natyrshme lind mbas përfundimit të Samitit të "Ballkan i Hapur" më 2 Shtator që u zhvillua nën suazën e Panairit Ushqimor në Beograd më 1 – 4 Shtator. Organizatorët e pompuan atë bashkë me verën që u derdh lumë si sukses i radhës i nismës "Ballkan i Hapur". Mirëpo tellallët e tij harrojnë se panairët dhe verërat nuk janë shpikje e "Ballkan i Hapur" por kanë histori shumë më të lashtë dhe në rajon. Për fatin e tyre të keq, përveç aromës dehëse të verës, ky edicion i "Ballkan i Hapur" politikisht ishte dështimi më i madh në prag të tre vjetorit të ekzistencës. Kryesorja, ai nuk ka bërë asnjë centimentër përpara në tre vendet refuzuese, sidomos në Kosovë, si dhe në publikun, median dhe politikën në Beograd, Tiranë dhe Shkup.

Në aspektin diplomatik, veç të përhershmit Soros që i shton dhe më shumë dozat e mosbesimit ndaj kësaj nisme, nuk pati asnjë mysafir nga metropolet e BE-së,



as nga Presidenca e saj çeke dhe as nga Uashingtoni. Madje, asnjë mesazh qoftë dhe personal prej tyre, siç ka ndodhur më parë.

Ndërkohë, Italia dhe Greqia e refuzuan për të dytën herë rresht ftesën, natyrisht me finesë diplomatike; diçka e pritshme, sepse Italia është protagoniste e Procesit të Berlinit, për të cilin kohët e fundit ka shprehur interes edhe Greqia.

Në aspektin diplomatik, veç të përhershmit Soros që i shton dhe më shumë dozat e mosbesimit ndaj kësaj nisme, nuk pati asnjë mysafir nga metropolet e BE-së, as nga Presidenca e saj çeke dhe as nga Uashingtoni. Madje, asnjë mesazh qoftë dhe personal prej tyre, siç ka ndodhur më parë. Ndërkohë, Italia dhe Greqia e refuzuan për të dytën herë rresht ftesën, natyrisht me finesë diplomatike; diçka e pritshme, sepse Italia është protagoniste e Procesit të Berlinit, për të cilin kohët e fundit ka shprehur interes edhe Greqia.

Italia është protagoniste e Procesit të Berlinit, për të cilin kohët e fundit ka shprehur interes edhe Greqia. Nuk e di sa ngushëllues ka qenë prania e kryediplomatëve nga Ankaraja dhe Budapesti, të cilët nuk janë në Procesin e Berlinit apo e Zarevit dhe Abazovicit” të rënë nga fiku”. Për ironi të fatit, në prag të Samitit, Fondacioni prestigjioz Rockeler, Euroactiv, ekspertë të mirënjohur ndërkombëtarë amerikanë, gjermanë, etj ua prishën fare shijen e verës dhe” oreksin” mysafirëve në Beograd. Sikur të mos mjaftonin këto, arbitrariteti i paparë dhe dhuna e shtetërore shqiptare në” Prestige Resort” e la në hije, duke u kthyer në një denoncim të ashpër publik të “Ballkan i Hapur”. Për pasojë, jehona në median rajonale dhe ndërkombëtare Zero.

Këtu nuk ka asgjë për t’u habitur. Tre liderët e tij nuk duan ta kuptojnë gjënë më të thjeshtë dhe logjike se ky Panair do të kishte shumë më tepër sukses, gjithëpërfshirje dhe jehonë po të ishte organizuar nën ombrellën e Procesit të Berlinit dhe Tregut të Përbashkët Rajonal të BE-së! Se aty do ishin të 6 vendet e rajonit dhe të paktën 6 herë më shumë firma pjesëmarrëse! Plus, personalitete nga Uashingtoni, Brukseli, Berlioni, Parisi, Roma, Londra, Praga që mban kryesinë e BE-së, etj. Por ja që karshillëku i dëmshëm ndaj Berlinit dhe Brukselit u ka zenë sytë” të kapurve” të Ballkan i Hapur” dhe nuk i lejon të shohin më larg se Beogradi, Tirana dhe Shkupi.!

Për pasojë, megjithë aromën e dhënë të verës dhe ahengjet politike të rastit, Panairi i Beogradit tregoi qartë se dhe tani, tre vjet

“

Tre liderët e tij nuk duan ta kuptojnë gjënë më të thjeshtë dhe logjike se ky Panair do të kishte shumë më tepër sukses, gjithëpërfshirje dhe jehonë po të ishte organizuar nën ombrellën e Procesit të Berlinit dhe Tregut të Përbashkët Rajonal të BE-së! Se aty do ishin të 6 vendet e rajonit dhe të paktën 6 herë më shumë firma pjesëmarrëse!

pas lançimit, “Ballkani i Hapur” ka mbetur një “Tripalësh Ballkanik “që nuk po ngjitet askund.

Nisur dhe nga përvoja e gjatë diplomatike në Tiranë dhe në vende të tjera me nismat rajonale, meqenëse po “këmbëngulet si Mushka “për gjoja dobinë e saj, duke përdorur si alibi qeveritare dhe “vijën e masave”, le të ndalemi “fshatshe” për të venë pikat mbi “i” mbi këtë nismë, e cila vazhdon të ndajë, në vend që të bashkojë.

“Ballkani i Hapur” është mbivendosje e panevojshme, sepse të gjitha objektivat dhe aspektet e tij i kryen më së miri Procesi i Berlinit. Madje, ai shkon shumë më larg në formatet dhe synimet e tij gjeopolitike, falë një platforme të gjerë bashkëpunimi dhe afrimi mes palëve. Veçse aty, “violinë e pare” është Berlioni dhe jo Beogradi, ndaj, Kosova dhe të tjerë janë te « Procesi i Berlinit», më shumë dëshirë dhe aktivë.

Nuk është aspak e vërtetë se Berlioni ka dështuar; përkundrazi, ai i ka shërbyer qëllimit,

i ka dhënë hov procesit të antarësimit në BE, me vlerësime nga BE/SHBA; pavarësisht se « Berlinez » aty janë aktorë të rëndësishëm dhe Italia, Franca, Anglia, Austria, Polonia, Bullgaria, etj. Po, ka patitur të meta, mangësi, vonesa dhe mungesa. Ama kjo kryesisht për faj të lidërshipeve në vendet tona që nuk “e kanë venë ujin shumë në zjarr” dhe tani na dalin si pa të keq me flamurin e shpëtimtarit!

Veç kësaj, pas vitit 2014 dhe Gjermania dhe BE-ja u ndeshën me kriza, konflikte dhe vështirësi të mëdha të njohura, të cilat patën ndikim dhe te Procesi i Berlinit.

Ndaj, siç e ka konfirmuar dhe Kancelari Scholz, në Shtator, Gjermania do ta rijetësojë këtë Proces historik, duke ftuar në Berlin të 6 liderët e rajonit.

Për të zbutur efektet e karshillëkut jashtë vendit, Kryeministri Rama pretendon se” Ballkan i Hapur” është njësi shtesë i zbatimit të Procesit të Berlinit! Çka bie në kundërshtim të plotë me fjalën e tij më 23 Qershor në Samitin e saj në Bruksel, ku krejt jashtë etikës minimale diplomatike “kërcënoi” BE-në ta mbështeste, ndryshe do

të bëhej kiameti! Ndërsa në Konferencën e Shtypit në Tiranë më 1 Gusht me Kryeministrin spanjoll Pedro Sanchez ai deklaroi se “Ballkani i Hapur” është nismë për jetë a vdekje!

Shqetësimi tjetër i madh është se dhe vetë Kryeministri Rama nuk do ta dëgjojë dhe ta kuptojë JO-në e qartë diplomatike nga partnerët gjermanë dhe evropianë. “Jo” për Ballkanin e Hapur dhe “PO” për Procesin e Berlinit e tha me shumë finesë ish Kancelarja Merkel dhe Ursula Von der Leyen Shtatorin dhe Tetorin e kaluar; atë ia tha akoma më troç Ramës në Berlin në Prill Kancelari Scholz përpara medias, duke mos e përmendur fare “Ballkan i Hapur” megjithë këmbënguljen e gazetarëve të pranishëm. Një “Jo” e kuptueshme, sepse Gjermania është nismëtarja e Procesit historik të Berlinit. Të njëjtin qëndrim mbajti Kancelari Scholz më 4 Maj në takimin me Kryeministrin e Kosovës Albin Kurti. Mirëpo kur thotë Berlinit “JO”, edhe Parisi, Haga e të tjerë nuk kanë si thonë “Po”.

“Jo” ka thënë në heshtje edhe SHBA-ja. Disa javë më parë, Kryeministri Rama pohoi publikisht se do të vijë një dokument strategjik shtesë nga SHBA-ja, ku është dakordësuar 100 për qind dhe për “Ballkanin e Hapur”. Mirëpo deri tani asgjë. Me përjashtim të Ndihmës Zv. Sekretarit të Shtetit Gabriel Escobar, i cili kohët e fundit e ka mbështetur, POR, me kusht ai që të jetë gjithëpërfshirës dhe vetëm ekonomik! Mirëpo, Rama në Beograd e sfidoi dhe vetë Escobar, kur e tha shqip në Beograd se “Ballkani i Hapur është

shumë më tepër se ekonomi dhe tregti, ai është shumë më tepër dhe se politikë, është projekt i madh paqeje”. Lind pyetja: “Po Procesi i Berlinit a nuk është i tillë, madje shumë më i madh dhe me efekt”? Pastaj, se kush e cënon dhe rrezikon paqen në rajon, këtë “e di dhe bufi”. Serbia, e cila në 30 vitet e fundit ka bërë 4 luftra të përgjakshme e tani na flet për paqe!!!

Nga ana tjetër, ndryshe nga “Ballkani i Hapur”, Procesi i Berlinit nuk ka nevojë për njësi shtesë, ai ka CEFTA, ka Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC) me seli në Sarajevë, ka Komunitetin e Energjisë dhe shumë nisma të tjera rajonale plotësuese. Atëhere, pse duhet “Ballkani i Hapur”, kur kemi këto mekanizmat dhe proceset e tjera, që janë dhe gjithëpërf-



“Jo” ka thënë në heshtje edhe SHBA-ja. Disa javë më parë, Kryeministri Rama pohoi publikisht se do të vijë një dokument strategjik shtesë nga SHBA-ja, ku është dakordësuar 100 për qind dhe për “Ballkanin e Hapur”. Mirëpo deri tani asgjë. Me përjashtim të Ndihmës Zv. Sekretarit të Shtetit Gabriel Escobar, i cili kohët e fundit e ka mbështetur, POR, me kusht ai që të jetë gjithëpërfshirës dhe vetëm ekonomik!



shirëse, konsensuale dhe gëzojnë mbështetjen e plotë të BE-së dhe SHBA-ve?

Gjithashtu, “Ballkani i Hapur” është i panevojshëm dhe karshillëk ndaj BE-së, sepse në vijim të Procesit të Berlinit, bashkë me të 6 liderët e Rajonit në Nëntor 2020 është miratuar projekti madhor “Tregu i Përbashkët Rajonal i Ballkanit Perëndimor” (TPR). Më specifikisht ai do të zbatojë të “katër liritë e mëdha të Europës. Mirëpo, si Rama dhe Vuçiç nuk e përmendin asnjëherë ose fare kalimthi as këtë projekt madhor; kështu bënë dhe në Beograd. E kemi përmendur dhe në shkrime të mëparshme se “Tregu i Përbashkët Rajonal” është fiksuar zyrtarisht dhe nuk e “luan as topi” në dokumentet zyrtare të BE-së. Këshilli e ka vulosur TPR-ja në Samitin e Sofjes më 10 Nëntor 2020, në Brdo më 6 Tetor 2021 dhe në Bruksel më 14 Dhjetor 2021; Komisioni European në Tetor 2020 dhe Parlamenti European në Rezolutën e tij të muajit Prill 2022. Ndërsa “Ballkani i Hapur” nuk përmendet si term në asnjë dokument zyrtar; as pas “rrufeve” që lëshoi Rama!

Madje, në pikat 10,11 dhe 12 të këtyre dokumentave zyrtare, të 6 liderët ballkanikë bashkë me Ramën zotohen për realizimin e TPR-së. Mirëpo, ndryshe nga “Ballkani i Hapur”, TPR-ja është gjithëpërfshirës dhe ka mbështetje politike/financiare nga BE-ja. Krahas mbështetjes dhe koperurës politike dhe institucionale, BE-ja ka akorduar 29 miliard Euro në kuadrin e Planit të saj të Investimeve në Rajonin tonë deri në vitin 2027 për zbatimin e TPR-së dhe projekteve të tjera që

ajo drejton. Në këto kushte, BE-ja, Brukseli dhe Berlioni nuk ka si “të zgjidhë qesen” për një nismë gjysmake, e cila ka për nismëtare Beogradin problematik; se kësaj i thonë “dhentë dhe dhinë e Zeres dhe nami i Hasan Qerres”!!

Mirëpo, sërish Kryeministri Rama nuk le rast pa gjykuar dhe kritikuar edhe TPR-në, si të dështuar, të ngadalshme në zbatimin e projekteve etj; Në fakt, “burokracia e Brukselit” nuk ka asnjë faj, sepse ajo ka rregullat dhe procedurat e saj, të cilat duhen respektuar një për një, ama europianëve dhe jo alla shqiptarëve!

Tani, nëse siç pretendon Rama, Procesi i Berlinit dhe TPR-ja kanë dështuar dhe na del shpëtimtar “Ballkani i Hapur” atëherë lind pyetja: “Kur nuk ka sukses Berlioni, Brukseli, Parisi, Roma, Londra, etj si mund t’ia dali mbanë Tirana me Beogradin”? Cili njeri në botë mund ta besojë këtë! Kësaj i thonë “më i rëndë bishti se sqepari”!

Argumenti tjetër i fortë kundër “Ballkanit të Hapur” është agresioni rus ndaj Ukrainës dhe qëndrimi i vendeve antare/kandidate ndaj Rusisë si “gur prove” Ai agresion, i shoqëruar me pasoja tejet të rënda për ekonominë europiane tregoi ndër të tjera dhe dështimin e globalizmit naiv, sipas të cilit, krijimi dhe zhvillimi i tregjeve, i zonave të lira, etj do të zgjidhte tensionet politike dhe do të krijojnë paqe; i tillë është dhe rasti i nismave rajonale, sidomos “Ballkani i Hapur” që ka bartur e krijuar shumë probleme, me mungesë të theksuar të besueshmërisë politike dhe tensione në rritje midis Beogradit dhe Prishtinës.

Më konkretisht, nëse nuk vendos sanksione ndaj Rusisë dhe vazhdon të ushqehesh në grazhdin e saj, atëherë, çkuptim ka të hapësh Ballkanin, kur ti mbyllesh ndaj Europës dhe Ukrainës? Ndaj, sot, përpara verës, konjakut, shalqinit, pra bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar, të gjithëve, por sidomos Serbisë problematike i kërkohet përcaktimi i pozicionit të saj gjeopolitik dhe ndarja me Rusinë. Nëse “Ballkani i Hapur” është projekt paqeje, atëherë, Serbia përpara se ta ftojë në atë nismë, le të njohë krimet dhe genocidin ndaj Kosovës, të kërkojë ndjesë publike dhe të shpallë njohjen e saj, qoftë dhe shkallë shkallë! Këtë të kërkojë dhe Rama dhe jo të bëhet zëdhënës i zellshëm i Beogradit, për t’i shpjeguar Europës vështirësitë energjitike serbe apo për t’i thurur lavde Vuçiç, si shpëtimtar i situatave konfliktuale, kur “dhe bufi e di” se është krejt e kundërta me të!

Për të gjitha këto shkaqe dhe arsye, JO-ja ndaj Ballkanit të Hapur është e pakthyeshme dhe e pakorrigjueshme, siç shpresojnë me naivitete partizanët e e tij fanatikë. Për Ballkanin e Hapur

nuk ka konsensus brenda saj; në një rast të tillë, krahas disa mbështetësve, kundërshtarët më të shumtë dhe më me ndikim do të pyesnin me të drejtë se përse do shtuar diçka tjetër kur TPR-ja i plotëson të gjitha kushtet? Pra, përse na duhen paralelizma dhe dublime të tilla, apo për protagonizëm rajonal? Ndaj janë të kota dhe ftesat për t’iu bashkuar asaj.

Në mbyllje, nuk është nevoja të “kërkojmë gjilpërë në kashtë” për të zbuluar të këqiat e “Ballkanit të Hapur”! Jo, Zoti Vuçiç, sepse “fshati që duket s’do kallauz”.

Ndaj, do të ishte më e udhës që në prag të Samitit në Berlin në Shtator dhe në Pragë në Tetor, të hiqet dorë “me lezet” nga “Ballkani i Hapur”. Të tria vendet të shpallin shkrirjen e tij të “Procesi i Berlinit dhe Tregu i Përbashkët Rajonal”, duke i dhënë fund këtij karshillëku të turpshëm dhe të dëmshëm. Sepse, le ta themi me zë të lartë për ata që duan të dëgjojnë: “Ballkani i Hapur” nuk ngjit dot më, sikur namin të bëjnë protagonistët e tij të zellshëm! Sepse, kuptojeni më në fund, Procesi i Berlinit dhe TPR-ja “na del dhe na tepëron”!



Argumenti tjetër i fortë kundër “Ballkanit të Hapur” është agresioni rus ndaj Ukrainës dhe qëndrimi i vendeve antare/kandidate ndaj Rusisë si “gur prove” Ai agresion, i shoqëruar me pasoja tejet të rënda për ekonominë europiane tregoi ndër të tjera dhe dështimin e globalizmit naiv, sipas të cilit, krijimi dhe zhvillimi i tregjeve, i zonave të lira, etj do të zgjidhte tensionet politike dhe do të krijojnë paqe; i tillë është dhe rasti i nismave rajonale, sidomos “Ballkani i Hapur” që ka bartur e krijuar shumë probleme, me mungesë të theksuar të besueshmërisë politike dhe tensione në rritje midis Beogradit dhe Prishtinës.

EKSKLUZIVE/ Ambasadori i Kinës në Shqipëri Z. Zhou Ding: Kina e Shqipëria duhet të shikojnë nga historia për të ndërtuar të ardhmen!



INTERVISTOI: MARJANA DODA

M

Me rastin e Ditës Kombëtare Kineze dhe në kuadrin e Javës Kulturore Kineze, Argumentum.al zhvilloi një intervistë me Ambasadorin e Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri Z. Zhou Ding.

“Kina e Shqipëria kanë tradita historike dhe në duhet të shikojmë nga historia për të ndërtuar të ardhmen. Kjo është ajo që adresoj të miqtë shqiptarë. Bashkëpunimi dypalësh pragmatik ka perspektiva të gjera, dhe potencial shume të madh në të gjitha fushat, ekonomike, politike dhe kulturore”, shprehet Ambasadori

Ndërsa thekson se Kina mbështet rrugën e integ-

rimet europian të Shqipërisë në BE dhe zhvillimit të marrëdhënieve diplomatike me të gjitha vendet, Ambasadori thotë gjithashtu se Kina mund të japë më shumë kontribut për Shqipërinë.

“Ka shumë potenciale midis dy vendeve por duhen përpjekje të përbashkëta dhe jo vetem nga njëra anë”, tha Ambasadori kinez.

INTERVISTA E PLOTË

Z. Ambasador, në kuadrin e nismës “Shqipëria mirëpret botën” e cila vjen si bashkëpunim i qeverisë shqiptare me vende të tjera mike e partnere në vend, janë organizuar një sërë javësh kulturore ndërkombëtare. Na flisni më shumë për programin e Javës së Kulturës Kineze, ku Shqipëria do të njihet me disa copëza të një kulture 5 mijëvjeçare?

Ambasadori i Kinës në Shqipëri Z. Zhou Ding

Kina shpreson që të japë më shumë kontribut për Shqipërinë. Siç e kam përmendur marrëdhëniet kino-shqiptare kanë shume potencial. Aktualisht Kina është partneri më i madh tregtar në më shumë se 130 vende në bote. Ndërsa me Shqipërinë Kina është vendi i pestë sa i perket shkëmbimit tregtar. Ka shume potenciale midis dy vendeve në fusha të tregtisë dhe investimit, por duhet përpjekje të perbashket dhe jo vetëm nga njëra anë.

Ne kemi përgatitur shume aktivitete në javën e kulturës kineze me qëllim që shqiptarët mund të njihen më shumë me kulturën kineze. Megjithatë një javë nuk është e mjaftueshme, por ne duam të paraqesim elemente kulturore kineze, si psh Arti marcial Taiji, ushqim kinez etj. Veçanërisht me foto sot në ekspozitë, shqiptarët mund të njihen me historinë e bashkëpunimeve në fusha arsimore, kulturore, etj.

Më kryesorja është entuziazmi që sjellin këto elemente kulturore te populli shqiptar. Shpresojmë që pas Javës së Kulturës Kinze, mund të organizojmë më shumë aktivitete. Si dhe më shumë shqiptarë të vizitojnë Kinën.

Përveç kësaj, shpresoj që edhe më shume kinez të mund të vizitojnë Shqipërinë. Besoj se me shkëmbime të tilla, miqësia ndërmjet dy vendeve mund të thellohet.

Aktualisht ndodhemi në ekspozitën e fotografive historike miqësore Kino-Shqiptare. Si ambasadori kinez, si e komenton këtë ekspozitë?

Misioni ynë origjinal për këtë ekspozitë, është pikërisht të ndihmojë më shumë shqiptarët që të njohin miqësinë tradicionale midis Kinës dhe Shqipërisë.

Në vitet 60-70 të shekullit të kaluar, Kina ka ndihmuar Shqipërinë me shumë projekte. Më shumë se 140 projekte, që mbulonin të gjitha fushat ekonomike dhe shoqërore. Edhe shumë shqiptarë shkuan në Kinën për të studiuar, punuar dhe vizituar. Ne duhet të vlerësojmë këtë histori. Kina e Shqipëria kanë tradita të vlerësimit të historisë, ne duhet të shikojmë nga historia për të ndërtuar të ardhmen. Kjo është ajo që adresoj te miqtë shqiptarë. Bashkëpunimi dypalësh pragmatik ka perspektiva të gjera, dhe potencial shumë të madh në të gjitha fushat, ekonomike, politike dhe kulturore. Kina është ekonomia e dytë botërore dhe dëshiron të japë kontribute të rëndësishëm për te

promovuar paqen dhe harmoninë botërore, si dhe për zhvillimin shqiptar.

Kjo intervistë po zhvillohet në prag të 73-vjetorit e vendosjes marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve tona, Si i vlerësoni këto marrëdhënieve gjatë këtyre viteve, veçanërisht në aspektin ekonomik?

Marrëdhëniet kino-shqiptare janë në bazë të barazisë dhe përfitimit reciprok. Kina mbështet rrugën e integritetit evropian të Shqipërisë në BE dhe zhvillimit të marrëdhënieve diplomatike me të gjitha vendet.

Kina shpreson që të japë më shumë kontribut për Shqipërinë. Siç e kam përmendur marrëdhëniet kino-shqiptare kanë shume potencial. Aktualisht Kina është partneri më i madh tregtar në më shumë se 130 vende në bote. Ndërsa me Shqipërinë Kina është vendi i pestë sa i perket shkëmbimit tregtar. Ka shume potenciale midis dy vendeve në fusha të tregtisë dhe investimit, por duhet përpjekje të perbashket dhe jo vetëm nga njëra anë.

Dhe së fundi, cili është mesazhi Juaj për të rinjtë shqiptarë?

Në të vërtetë jam takuar me shumë të rinj shqiptarë. Ata janë shumë të zgjuar dhe të hapur. Siç e kam përmendur, janë të shumtë të rinjtë shqiptarë që kanë mësuar gjuhën kineze në institutin "Konfuci" dhe më kanë thënë që duan të vizitojnë Kinën.

Shqipëria ka pasuri në burime njerëzore, siç janë të rinjtë shumë të gjallë, ndaj Shqipëria ka shumë potencial në këtë aspekt. Edhe Shqipëria ka burime natyrore të pasura. Ambasada kineze dëshiron të forcojë bashkëpunime me palën shqiptare, psh në fushën e bashkëpunimit midis të rinjve. Uroj që shumë të rinj të njihen me shumë me Kinën, të vizitojnë në Kinë pas pandemisë.

Faleminderit!

MBRETËRESHA ELIZABETH

ndërron jetë në moshën 96-vjeçare,
duke i dhënë fund një epoke për Britaninë



Mbretëresha Elizabeth II, monarkja më jetëgjatë në Mbretërinë e Bashkuar, ka vdekur në Balmoral në moshën 96-vjeçare, pasi mbretëroi për 70 vjet.

Djali i saj Mbreti Charles III tha se vdekja e nënës së tij të dashur ishte një “moment i madh pikëllimi” për të dhe familjen e tij dhe se humbja e saj do të “ndihej thellësisht” në mbarë botën.

Anëtarët e familjes mbretërore ishin mbledhur në pronën e saj skoceze pasi shqetësimet u rritën për shëndetin e saj më herët të enjten.

Mbretëresha erdhi në fron në vitin 1952 dhe dëshmoi ndryshime të mëdha shoqërore.

Mbreti Charles tha: “Ne vaj-

tojmë thellësisht vdekjen e një sovrani të dashur dhe një nëne shumë të dashur.

“Unë e di se humbja e saj do të ndihet thellësisht në të gjithë vendin, mbretëritë dhe Commonwealth, dhe nga njerëz të panumërt në mbarë botën.”

Ai do të udhëheqë vendin në zi si Mbreti i ri dhe kreu i shtetit për 14 sferat e Commonwealth. Camilla, gruaja e tij, bëhet Queen Consort.

Gjatë periudhës së ardhshme, ai tha se ai dhe familja e tij do të “ngushëllohen dhe mbështeten nga njohuritë tona për respektin dhe dashurinë e thellë në të cilën mbretëresha mbahej kaq gjerësisht”.

Në një deklaratë, Buckingham Palace tha: “Mbretëresha vdiq

paqësisht në Balmoral këtë pasdite.

“Mbreti dhe bashkëshortja e Mbretëreshës do të qëndrojnë në Balmoral këtë mbrëmje dhe do të kthehen në Londër nesër.”

Të gjithë fëmijët e Mbretëreshës udhëtuan në Balmoral, afër Aberdeen, pasi mjekët e vendosën Mbretëreshën nën mbikëqyrjen mjekësore.

Nipi i saj dhe tani trashëgimtari i fronit, Princi William, është gjithashtu atje, me vëllain e tij, Princin Harry, në rrugë.

Kryeministrja Liz Truss, e cila u emërua nga Mbretëresha dy ditë para ndarjes nga jeta, tha se monarku ishte shkëmbi mbi të cilin u ndërtua Britania moderne, i cili “na kishte siguruar stabilitetin dhe forcën që



kishim nevojë”.

Duke folur për Mbretin e ri, ajo tha: “Ne i ofrojmë atij besnikërinë dhe përkushtimin tonë, ashtu si nëna e tij u kushtoi kaq shumë, kaq shumë njerëzve, për kaq shumë kohë.

“Dhe me kalimin e epokës së dytë Elizabetiane, ne hapim një epokë të re në historinë madhështore të vendit tonë të madh, pikërisht ashtu siç do të kishte dëshiruar Madhëria e saj, duke thënë fjalët “Zot ruaje Mbretin”.

Mandati i Mbretëreshës Elizabeth II si kreu i shtetit përfshiu masat shtrënguese të pasluftës, kalimin nga perandoria në Commonwealth, fundin e Luftës së Ftohtë dhe hyrjen dhe tërheqjen e Mbretërisë së Bashkuar në Bashkimin Evropian.

Sundimi i saj zgjati 15 kryeministra duke filluar me Winston Churchill, i lindur në 1874, dhe duke përfshirë zonjën Truss, të lindur 101 vjet më vonë në 1975.

Ajo mbajti audienca javore me kryeministrin e saj gjatë gjithë mbretërimit të saj.

Në Pallatin Buckingham në Londër, turmat që prisnin përditësimet për gjendjen e mbretëreshës filluan të qanin ndërsa dëgjuan për vdekjen e saj. Flamuri i Unionit në majë të pallatit u ul në gjysmështizë në orën 18:30 BST dhe një njoftim zyrtar që njoftonte vdekjen u postua jashtë.

Pas vdekjes së Mbretëreshës, Princi William dhe gruaja e tij, Catherine, u bënë Duka dhe Dukeshë e Kembrixhit dhe



Cornwall-it.

Mbretëresha lindi Elizabeth Alexandra Mary Windsor, në Mayfair, Londër, më 21 prill 1926.

Pak mund ta kishin parashikuar se ajo do të bëhej monarke, por në dhjetor 1936 xhaxhai i saj, Eduardi VIII, abdikoi nga fronin për t'u martuar me amerikanen e dy herë të divorcuar, Wallis Simpson.

Babai i Elizabeth u bë Mbreti George VI dhe, në moshën 10-vjeçare, Lilibet, siç njihej në familje, u bë trashëgimtare e fronit.

Brenda tre viteve, Britania ishte në luftë me Gjermaninë naziste. Elizabeth dhe motra e saj më e vogël, Princesha Margaret, kaluan pjesën më të madhe të kohës së luftës në Kështjellën Windsor pasi prindërit e tyre refuzuan sugjerimet që ata të evakoheshin në Kanada.

Pasi mbushi 18 vjeç, Elizabeth kaloi pesë muaj me Shërbimin Territorial Ndihmës dhe mësoi aftësitë bazë të mekanikës motorike dhe drejtimit. “Fillova të kuptoj esprit de corps që lulë-

zon përballë fatkeqësisë,” kujtoi ajo më vonë.

Gjatë luftës, ajo shkëmbeu letra me kushëririn e saj të tretë, Filipin, Princin e Greqisë, i cili shërbente në Marinën Mbretërore. Romanca e tyre lulëzoi dhe çifti u martua në Westminster Abbey më 20 nëntor 1947, me princin që mori titullin Duka i Edinburgut.

Ajo më vonë do ta përshkruante atë si “forca dhe qëndrimi im” gjatë 74 viteve të martesës, para vdekjes së tij në 2021, në moshën 99-vjeçare.

Djali i tyre i parë, Charles, lindi në 1948, i ndjekur nga Princesha Anne, në 1950, Princi Andrew, në 1960 dhe Princi Eduard, në 1964. Mes tyre, ata u dhanë prindërve tetë nipër e mbesa dhe 12 stërnipër.

Princesha Elizabeth ishte në Kenia në vitin 1952, duke përfaqësuar Mbretin e sëmurë, kur Filipi dha lajmin se babai i saj kishte vdekur. Ajo u kthye menjëherë në Londër si mbretëresha e re.

“Ishte e gjitha një lloj shumë i papritur për të marrë përsipër dhe për të bërë punën më të



mirë që mundesh,” kujtoi ajo më vonë.

Elizabeth u kurorëzua në Westminster Abbey më 2 qershor 1953, në moshën 27-vjeçare, para një audiencë televizive të atëhershme rekord që vlerësohej në më shumë se 20 milionë njerëz.

Dekadat e mëvonshme do të shihnin ndryshime të mëdha, me fundin e Perandorisë Britanike jashtë shtetit dhe vitet '60 të lëkundura duke fshirë normat sociale në shtëpi.

Elizabeth reformoi monarkinë për këtë epokë më pak të respektueshme, duke u angazhuar me publikun përmes shëtitjeve, vizitave mbretërore dhe pjesëmarrjes në ngjarje publike. Angazhimi i saj ndaj Commonwealth ishte i vazhdueshëm – ajo vizitoi çdo vend të Commonwealth të paktën një herë.

Por kishte periudha dhimbjeje private dhe publike. Në vitin 1992, zjarri i “annus horribilis” i Mbretëreshës shkatërroi Kështjellën Windsor – një rezidencë private si dhe një pallat pune – dhe martesat e tre fëmijëve të saj u prishën.

Pas vdekjes së Dianës, Prince-shës së Uellsit, në një aksident automobilistik në Paris në 1997, Mbretëresha tërhoqi kritika për paraqitjen e ngurrar për t’u përgjigjur publikisht.

Kishte pyetje në lidhje me rëndësinë e monarkisë në shoqërinë moderne.

“Asnjë institucion... nuk duhet të presë të jetë i lirë nga shqyrtimi i atyre që i japin besnikërinë dhe mbështetjen e tyre, për të mos përmendur ata që nuk e bëjnë,” pranoi ajo.

Si një princeshë 21-vjeçare,

Elizabeth ishte zotuar t’i kush-tonte jetën e saj shërbimit.

Duke reflektuar mbi ato fjalë dekada më vonë, gjatë jubileut të saj të argjendtë në 1977, ajo deklaroi: “Megjithëse ai betim u bë në ditët e sallatës sime, kur isha i gjelbër në gjykim, nuk pendohem dhe as tërhiqja asnjë fjalë të tij.”

I njëjti angazhim për të shërbyer u bë 45 vjet më vonë në një letër falënderimi drejtuar kombit në fundjavën e jubileut të saj Platinum në qershor.

Ky moment u festua me një përzierje ceremonish shtetërore dhe një festival shumëngjyrësh të të gjitha gjërave britanike, si dhe festa të gjalla në rrugë.

Edhe pse shëndeti i mbretëreshës e mbajti atë nga disa ngjarje, ajo tha: “Zemra ime ka qenë me të gjithë ju”.

Presidenti Putin shpall mobilizim të pjesshëm në Rusi, dhe anekson 4 rajone të Ukrainës



Presidenti rus Vladimir Putin njoftoi një mobilizim të pjesshëm në një fjalim televiziv drejtuar kombit të mërkurën, duke vënë në dukje kërcënimet ndaj ekzistencës së vendit të paraqitura nga Perëndimi dhe natyrën e pashmangshme të operacionit special ushtarak në Ukrainë.

Vija e shtrirë e frontit, granatimet e vazhdueshme të zonave kufitare ruse nga ushtria ukrainase dhe sulmet në rajonet e çliruara kërkonin thirrjen e ushtarakëve nga rezerva, shpjegoi Putin.

Rusia do të thërrasë rezervistët që kanë shërbyer tashmë në ushtri dhe do të organizojë trajnimin e tyre. Rezervistët dhe vullnetarët e Donbass do të kenë të njëjtat garanci që gëzojnë ushtarakët me kontratë.

Linja e angazhimit luftarak tani shtrihet mbi 1000 km në operacionin ushtarak special në Ukrainë, ndërkohë që sulmet terroriste nga armët perëndimore tashmë janë duke u kryer kundër zonave kufitare ruse. “NATO po kryen zbulim në të gjithë jugun e Rusisë në kohë reale, duke përdorur sisteme të avancuara, avionë dhe anije, satelitë dhe drone strategjike”.

Siç propozohet nga Shtabi i Përgjithshëm i Rusisë dhe Ministria e Mbrojtjes, Rusia do të thërrasë një mobilizim të pjesshëm dhe këto masa do të fillojnë që më 21 shtator.

Rusia do të thërrasë rezervistët, kryesisht ata që kanë shërbyer në ushtri. Qytetarët e mobilizuar do t'i nënshtrohen trajnimeve të kërkuara dhe do të gëzojnë të njëjtat garanci që i jepen personelit me kontratë. Qeveria ruse dhe Ministria e Mbrojtjes do të barazojnë formacionet vullnetare të Donbasit me ushtarakët rusë në statusin e tyre.

Autoritetet ruse gjithashtu do të zgjidhin menjëherë të gjitha çështjet që lidhen me sigurimin e ndërmarrjeve të industrisë së mbrojtjes me furnizimet dhe burimet e nevojshme financiare.

ANEKSIMI I 4 RAJONEVE TË UKRAINËS/

Fjalimi i Putinit: Rusia pranon rajone të reja dhe fton edhe një herë Kievin për të biseduar



Moska, do të mbrojë territoret e saj të reja “me të gjitha forcat dhe mjetet në dispozicion”, theksoi Putin.

Rusia është gati të rifillojë negociatat me Ukrainën, por nuk do të diskutojë zgjedhjen e banorëve të rajoneve Donbass, Zaporozhye dhe Kherson: ata janë bërë rusë një herë e përgjithmonë, tha Presidenti rus Vladimir Putin të premten gjatë ceremonisë për pranimin e katër vendeve rajoneve të reja në vend.

Moska, siç theksoi lideri rus, do të mbrojë territoret e saj të reja “me të gjitha forcat dhe mjetet në dispozicion” dhe Perëndimi nuk ka të drejtë morale të kundërshtojë rezultatet e referendumeve në Donbas dhe në territoret e çliruara. Putini ia kushtoi pjesën më të madhe të fjalimit të tij kritikave ndaj politikave perëndimore, akuzoi drejtpërdrejt “anglo-saksonët” për orkestrimin e bombardimeve të Rrjedhës Veriore dhe përmendi se SHBA “kishte krijuar një precedent” për përdorimin e armëve bërthamore.

TASS përpiloi deklaratat kryesore të Putinit, të cilat i sjell në shqip Argumentum.al



Kreu i Rajonit Kherson Vladimir Saldo, Kreu i Rajonit Zaporozhye Evgeny Balitsky, Presidenti rus Vladimir Putin, Kreu i Republikës Popullore të Donetsk Denis Pushilin dhe kreu i Republikës Popullore të Luganskut Leonid Pasechnik

Rajone të reja

Banorët e Donbass, si dhe të rajoneve Zaporozhye dhe Kherson “kanë bërë zgjedhjen e tyre, një zgjedhje e qartë”: “Njerëzit që jetojnë në Lugansk dhe Donetsk, si dhe në rajonet Kherson dhe Zaporozhye janë bërë qytetarët tanë. Një herë e përgjithmonë.”

“Ne do të mbrojmë tokën tonë me të gjitha forcat dhe mjetet që kemi në dispozicion dhe do të bëjmë gjithçka për të siguruar jetën e sigurt të qytetarëve tanë. Ky është misioni i madh çlirimtar i popullit tonë.”

Rusia do të bëjë gjithçka për t’u siguruar që banorët e këtyre rajoneve të ndjejnë mbështetjen

e të gjithë vendit: “Ne patjetër do të rindërtojmë qytete dhe qyteza të shkatërruara, shtëpi, shkolla, spitale, teatro dhe muzeume. Ne do të restaurojmë dhe zhvillojmë ndërmarrje industriale, fabrika, infrastrukturën, sistemet sociale dhe pensionale, kujdesin shëndetësor dhe arsimin”.

Për bisedimet e paqes me Kievin

Ne i bëjmë thirrje regjimit të Kievit që menjëherë të pushojë zjarrin, të gjitha armiqësitë, të ndalojë luftën që kishte nisur në vitin 2014 dhe të kthehet në tryezën e bisedimeve.

Moska nuk do të diskutojë statusin e rajoneve të saj të reja në

këto bisedime: “Autoritetet e sotme të Kievit duhet ta trajtojnë këtë shprehje të lirë të vullnetit të popullit me respekt dhe në asnjë mënyrë tjetër. Vetëm kjo mund të jetë rruga drejt paqes. “Ne nuk do të diskutojmë zgjedhjen e njerëzve në Donetsk, Lugansk, rajonet Zaporozhye dhe Kherson, ajo është bërë. Rusia nuk do ta tradhtojë”.

Perëndimi nuk ka “asnjë të drejtë morale” për të vlerësuar rezultatet e referendumeve apo “madje për të folur për lirinë dhe demokracinë”: “Nuk ka dhe nuk ka kurrë”.

Për përballjen me Perëndimin

Perëndimi është gati të “kalo-

jë mbi gjithçka” në mënyrë që të ruajë “sistemin e tij neokolonial” që i lejon atij “të plaçkisë botën” dhe “të mbledhë haraç nga njerëzimi”. Diktatura e elitave drejtohet kundër popullit të vet dhe merr “tiparet e <...> satanizmit të plotë”.

Vendet perëndimore duan ta kthejnë Rusinë në një koloni dhe arsyet e vërteta të luftës hibride të nisur kundër saj janë “lakmia dhe synimi për të ruajtur fuqinë e tyre të pakufizuar”: “Ata nuk kanë nevojë fare për Rusinë, por ne kemi nevojë për të. Situata rreth Ukrainës, ata thjesht u demaskuan në thelb, duke treguar veten e tyre të vërtetë”.

Tani Perëndimi duhet të thyejë Rusinë me çdo kusht, por është një fuqi e madhe, e cila nuk do të jetojë sipas “rregullave të saj të montuara, të rreme” dhe do të luftojë për një “të ardhme të drejtë dhe të lirë”. Prishja e hegjemonisë perëndimore është e pakthyeshme, një “lëvizje çlirimtare antikoloniale” po zhvillohet brenda një sërë vendesh dhe shoqërisht: “Nuk do të jetë kurrë si më parë”.

PËR PËRBALLJEN ME PERËNDIMIN

Perëndimi është gati të “kalojë mbi gjithçka” në mënyrë që të ruajë “sistemin e tij neokolonial” që i lejon atij “të plaçkisë botën” dhe “të mbledhë haraç nga njerëzimi”. Diktatura e elitave drejtohet kundër popullit të vet dhe merr “tiparet e satanizmit të plotë”.

Mbi precedentin bërthamor

“SHBA është i vetmi vend në botë që ka përdorur armë bërthamore dy herë, duke shkatërruar qytetet japoneze të Hiroshima dhe Nagasaki. Nga rruga, ata krijuan një precedent.”

Mbi krizën globale

Elitat perëndimore nuk do të gjejnë zgjidhje konstruktive për krizën globale të ushqimit dhe energjisë që u ngrit me veprimet e tyre, por përkundrazi “ia kthejnë fajin Rusisë”: “Ata po gënjëjnë përsëri”.

Vetëm vlerat reale mund ta

kapërcejnë krizën: “Askush nuk mund të ngrohet me kapitalizime të fryra pasi nevojitet energji. Nuk mund të ushqesh askënd me para letre, ne kemi nevojë për ushqim.”

Rreth restaurimit të Bashkimit Sovjetik

Rënia e BRSS, në kundërshtim me vullnetin e drejtpërdrejtë të shumicës së banorëve të saj, u shndërrua në një katastrofë kombëtare, por Moska nuk dëshiron ta rivendosë atë: “Bashkimi Sovjetik nuk ekziston më, e kaluara nuk mund të rikuperohet. Madje edhe Rusia sot nuk ka nevojë për të, ne nuk e aspirojmë atë.”

Shqipëria dënon aneksimin nga Rusia për 4 rajonet e Ukrainës

Shqipëria ka dënuar aneksimin nga Rusia për 4 rajonet e Ukrainës, Donetsk, Luhansk, Kherson dhe Zaporizhzhia.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, përmes një reagimi në rrjetet sociale theksoi se “aneksimi i katër rajoneve të Ukrainës është i paligjshëm”.

“Qëndrimi i Shqipërisë është i qartë, ashtu si ai i SHBA, Bashkimit Evropian, NATO-s dhe shteteve

të tjera demokratike. Kundërshtojmë pa mëdyshje këtë veprim të njëanshëm të Rusisë, që shkel hapur të drejtat themelore të Ukrainës për pavarësi, sovranitet dhe integritet territorial”, theksoi Peleshi.

Moska ka mbajtur referendume që janë të paligjshme sipas ligjit ndërkombëtar në katër rajone ukrainase të pushtuara nga Rusia: në Kherson, Donetsk, Luhansk dhe Zaporizhzhia, për të justifikuar



aneksimin e tyre në Federatën Ruse.

Po ashtu Presidenti Bajram Begaj reagoi pasditen e sotme lidhur me aneksimin e territoreve ukrainase nga Rusia.

“Dënoj me forcë shkeljen e përsëritur të integritetit territorial të Ukrainës nga ana e Rusisë. Sfida e hapur dhe flagrante e Rusisë ndaj ligjeve dhe komunitetit ndërkombëtar është lajm i keq për paqen dhe rendin botëror”, u shpreh Begaj.

Ndërsa Ministria e Jashtme thekson se nuk do të njohë rezultatet e përcaktuara nga Rusia në këto rajone. Institucioni kyç për marrëdhëniet ndërkombëtare thekson se çdo aneksim i territorit të një shteti në një shtet tjetër sovran, është shkelje e parimeve të Kartës së OKB. Sidoqoftë, Putin ka shpallur zyrtarisht aneksimin e 4 rajoneve ndërsa theksoi se nuk ka për ti dorëzuar kurrë. Putin gjithashtu në deklaratat e tij u shpreh se Perëndimi është përgjegjës për sabotimin e Nord Stream si dhe dënoi ashpër zgjerimin e NATO-s në lindje.

Edhe në përfaqësinë tonë si anëtar jo të përhershëm të Këshillit të Sigurimit në OKB Xhaçka theksoi se Shqipëria mirëpret vendimin e Presidencës franceze dhe tha se veprimet e Rusisë janë në shkelje flagrante me Kartën e Kombeve të Bashkuara. Shefja e diplomacisë theksoi ndër të tjera se e drejta ndërkombëtare është e njëjtë dhe e detyrueshme për të gjithë dhe se Rusia ka

zgjedhur të injorojë atë. Ashtu sikundër perëndimi u përgjigj ndaj këtij agresioni, edhe Xhaçka e cilësoi ndërhyrjen e Moskës në Kiev, shkelje flagrante e pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës dhe një shkelje e rëndë e Kartës së OKB-së.

Edhe kreu i Partisë së Lirisë (FP), Ilir Meta ka dënuar vendimin e presidentit të Rusisë, Vladimir Putin dhe nënshkrimin e marrëveshjes për aneksimin e katër rajoneve të Ukrainës.

Meta përmes një statusi në Twitter të premten shkruan se Partia e Lirisë dënon ashpër referendimet e rreme të organizuara nga Rusia, duke shtuar se aneksimi i rajoneve Donetsk, Luhansk, Kherson, Zaporizhzhia është i papranueshëm.

“Partia e Lirisë dënon ashpër referendimet e rreme të organizuara nga Rusia në Ukrainë me rezultate të paracaktuara. Rajonet Donetsk, Luhansk, Kherson, Zaporizhzhia janë territore të Ukrainës dhe çdo aneksim i tyre nga Rusia është i papranueshëm, është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, si dhe çdo parim të sovranitetit dhe integritetit territorial”, tha Meta.

Moska ka mbajtur referendume që janë të paligjshme sipas ligjit ndërkombëtar në katër rajone ukrainase të pushtuara nga Rusia, në Kherson, Donetsk, Luhansk dhe Zaporizhzhia për të justifikuar aneksimin e tyre në Federatën Ruse.

Britania elisabetiane! Fjalë, fjalë 77! Pa lidhje dhe pa kuptim! Gjeopolitika fillon nga brenda!

REALPOLITIK "FLASH" NO. 54

16 – 30 SHTATOR 2022

EKSKLUZIVISHT PER ARGUMENTUM

Shkurt dhe Shqip mbi 4 ngjarjet kryesore diplomatike me vetëm 1000 fjalë nga analisti i njohur diplomatik, Mjeshtëri i Madh

DR. JORGJI KOTE MJESHTËR I MADH

1. Britania Elisabetiane! Kjo është Mbretëria e Bashkuar pas ceremonisë madhështore të lamtumirës për Mbretëreshën Elisabeta II. Me pjesëmarrjen masive, të ndjekur nga 5 miliard vetë, pritjet me orë të tëra për nderimet e fundit, rregulli dhe protokolli i paparë, prania e 500 liderëve botërorë ishin homazhi më prestigjioz që ka njohur bota. Si mirënjohje për jetën e saj të gjatë në shërbim të popullit, siç ishte betuar qysh në rinë. Me një rekord mbretërimi mes sfidash të panumurta, brenda familjes, në Britani dhe në gjithë botën, etj. Mbas epokës së famshme Viktoriane (1837 – 1901) Madhëria e saj, Elisabeta II, me 70 vitet e mbretërimit, i vuri vulën kësaj epoke në Angli dhe Comonwealthin britanik, me një imazh dhe autoritet rrezatues planetar.

2. Fjalë, fjalë pati Sesioni i 77 i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së që vazhdon në Nju Jork. Mbizotëroi agresioni rus ndaj Ukrainës me pasojat e njohura, mbështetja për Ukrainën, dënimi i Rusisë me sanksione dhe për t'i hequr të drejtën e vetos, propozime për procedimin e Putinit për genocid dhe krime ndaj njerëzimit, sfidat globale, klima dhe kriza energjitike, ushqimore, etj. Mirëpo, nisur



nga natyra e OKB-së, të gjitha mesazhet, sado të drejta dhe të dobishme nuk e kapërcyen dot pragun e fjalëve që janë bërë refren i rëndomtë. Edhe rezolutat e saj nuk janë të detyrueshme dhe nuk kanë vlerë pa kaluar në filtrin e Këshillit të Sigurimit. Ndonëse ka 20 vjet që të gjithë "ulërasin" për reformimin e saj, për zgjerimin e Këshillit të Sigurimit me vende të tjera me peshe, këto kanë mbetur vetëm dëshirë e mirë. Ndaj, sado fjalime bombastike të mbahen në « Pallatin e Qelqtë », ato harrohen sapo liderët kalojnë Atlantikun dhe ndeshen me realitetet e zymta në terren.

3. Pa lidhje dhe pa kuptim ishin disa tema në fjalimin e Kryeministrit Rama më 25 Shtator në Nju Jork. Veç solidaritetit me Ukrainën dhe dënimit të agresionit rus, çështjet e tjera ishin

irrelevante për atë tribunë të lartë, ndaj duhej të ishin shmangur. E para, përmendja e Raportit të Dick Martyt dhe Rezolutës përkatëse të Këshillit të Europës (KiE). Sepse pala jonë ka dorëzuar në Strasburg draft-Rezolutën vijuese për çvleftësimin e akuzave të pavërtetuara mbi trafikimin e qenieve njerëzore nga ish liderët e UÇK-së. Por të tjerat janë në proces gjykimi. Atëhere përse duhej ngritur ky problem në OKB? Apo për të denoncuar Gjykatën Speciale në Hagë! Kur dihet se lidhshipi i Kosovës dhe ai në Tiranë e kanë përkrahur këtë strukturë të mbështetur nga BE dhe SHBA! Eshte naivitet të mendosh se me një fjalim dhe lëvizje të tjera në Nju Jork, Bruksel dhe gjetkë mund të ndalosh apo të kërkojë mbylljen e saj! Por, dhe sikur kjo të ndodhë, sërish gjykimet në proces do të përfundojnë



me fajësi ose pafajësi dhe ne urojmë këtë të dytën. Deri atëherë nuk ka përse të flasim nëpër botë dhe paragjykojmë drejtësinë e pavarur ndërkombëtare. Në fund të fundit, nga ana formale, dhe Dick Marty ka ngritur akuza dhe pretendime, të cilat më 2010 KiE-ja vendosi t'i referonte drejtësisë ndërkombëtare me 169 vota pro dhe vetëm 22 kundër/abstenime. Ndaj, është më e udhës të punohet me vendet antare në Strasburg që të miratohet Rezoluta jonë, ndryshe ka rrezik që "në vend të vemë vetullat, të nxjerrim sytë"

Pa lidhje ishte përmendja e "Ballkan i Hapur" kur në OKB shumë pak e njohin dhe nuk ka interes për një trilateral dhe ai gjysmak! Më e keqja, duke mos përmendur Procesin e Berlinit dhe Tregun e Përbashkët Rajonal t'i shpreh një karshillëk të dëmshëm ndaj Berlinit, Brukselit, metropoleve të tjera të BE-së dhe SHBA-ve. Dhe kjo vetëm një muaj para Takimit në Berlin më 3 Nëntor për jetësimin e Procesit të Berlinit me ftesë të Kancelarit Scholz. Mos përmendja e BE-së në atë fjalim e "trash dhe më shumë zullumin » euroskeptik. Irelevante ishte dhe përmendja e mundësisë së pranisë së Greqisë dhe Turqisë te Ballkan i Hapur, një non-sens i vërtetë nga çdo anë. Imagji-

noni si mund të pranojnë këto dy vende, sidomos Turqia të vihet nën hyqmin e Tiranës dhe Beogradit!

Pa kuptim ishin avokatia dhe thirjet për të mos bërë presion ndaj Serbisë për mosvendosjen e sanksioneve ndaj Rusisë, sepse demokracia është e varur prej tyre. Por, ç'tu themi vendeve të tjera që po bëjnë çmos për t'i dhënë fund asaj vartësie por prapë kanë vendosur sanksione? Po Marrëveshja e Beogradit për konsultime diplomatike me Lavrov aty në Nju Jork kur liderët e tjerë nuk i dhanë as dorën?

Nga ana tjetër, thirjet e Ramës për dialog për Serbinë dhe Kosovën, pa asnjë dallim e duke i vënë në një plan të barabartë për fajet dhe përgjegjësinë e tyre është po aq pa kuptim dhe gafë diplomatike. Siç është dhe raporti që ka krijuar Rama midis Beogradit dhe Prishtinës, dukshëm në favor të të parit!

4. Gjeopolitika fillon nga brenda! Në forume rajonale dhe ndërkombëtare vazhdon "avazi i Mukes" me kërkesën ndaj BE-së që të përshpejtojë zgjerimin drejt Ballkanit Perëndimor, për të shmangur ndërhyrjet dhe rrezikun rus, kinez, etj. Mirëpo, me këtë kërkesë po abuzohet shumë. Deri tani shohim vetëm

gjeopolitikë por pothuasje asgjë për reformat e brendshme. Ca më tepër kur gjeopolitika e ka bërë të vetën; kështu, negociatat Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut janë çelur, po akordohen shumë të mëdha financiare për reformat, në Tetovë në Samitin e Pragës do të shpallet krijimi i Komunitetit Politik Europian, ku do të jenë të 6 vendet e rajonit tonë, etj. Ndaj tani mbetet që vendet tona të vazhdojnë me më shumë intensitet reformat, të kurojnë plagët e shumta, mbi të gjitha azilin e paligjshëm që po merr përmasa të frikshme, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, etj. Mirëpo, këto dhe të tjera probleme nuk i zgjidh dot gjeopolitika dhe BE-ja nga jashtë.

Ndaj, kujdes, nëse nuk punojmë nga brenda, me gjeopolitikë "mund të nxjerrim rrezikun rus jashtë nga dera, por shumë shpejt ai do të na hyjë nga dritarja". Gjeopolitika mund të nxisë dhe të përshpejtojë, por vendimtare për suksesin e antarësimit në BE janë aktorët, faktorët dhe reformat e brendshme; ku te ne tani po bëhen hapa mprapa, si me tre projekt-ligjet e fundit në kundërshtim të hapur me BE-në. Ca më keq akoma, vërtet kemi qeveri dhe qeveritarë, por ata çuditërisht po çqeverisin me arrogancë!

Kryeministri Rama iu nënshtrohet kushteve të Erdogan...mbyll shkollat e Gylenit dhe blen dronë “Bayraktar” nga Turqia



Këshilli i Ministrave i Shqipërisë vendosi më 22 shtator mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor privat parauniversitar kolegjit “Mehmet Akif Ersoy”, i cili operonte në Tiranë që 26 vjet dhe që është pjesë e Fondacionit Gülistan.

Në të njëjtën ditë me vendimin e qeverisë për mbylljen e kolegjit “Mehmet Akif” në Tiranë që është themeluar nga Lëvizja Gulen dhe pak ditë pas mbylljes së një kopshti privat për fëmijë, “Zubeyde Hanim” që është pjesë e shoqërisë “Turгут Ozal Education”, Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama tha se gjatë takimit të fundit me

Presidentit turk, Rexhep Taip Erdogan, ka folur për marrëveshjen e furnizimit me dron “Bayraktar”.

Kështu gjatë një interviste për “Opinion” Rama konfirmoi se Shqipëria do të marrë 6 dron nga Turqia, të cilët do të përdoren për shërbime civile.

Nuk dihet nëse vendimi për të mbyllur këto institucione arsimore i ka hapur rrugë blerjes së droneve Bayraktar nga Turqia, por gjithsesi në kronologjinë e marrëdhënieve Shqipëri-Turqi përgjatë muajve të fundit, janë disa momente kyçe që tregojnë një ftohje të këtyre marrëdhënieve për shkak të

Lëvizjes Hizmet (Gulen).

Pas takimit “kallkan” Erdogan – Rama» në Ankara, Turqia dha dy dëshmi të tjera të hatërmbetjespolitike me Tiranën zyrtare. Disa javë më parë, Ministri i Jashtëm Cavutoglu kreu një tur ballkanik, por e shmangu Tiranën. Dhe në Samitin e Ballkan i Hapur në Beograd nuk e takoi Edi Ramën. Ndërkohë, më 7 – 9 Shtator, Presidenti Erdogan ishte në një tur ballkanik, por sërish e « harroi » Tiranën. Ndonëse kishte premtuar se do të shkonte atje në muajin Maj. Ka dhe të dhëna e aludime të tjera që tregojnë qartë se Tirana zyr-

tare duhet të plotësojë kërkesat e Ankarasë lidhur me dëbimin e elementëve gjylenistë në fushën e arsimit, kulturës, biznesit dhe nga Kryesia e Komunitetit Mysliman; ndryshe, « harro mushkë Valarenë » Shkurt hesapi, Erdogani i thotë « vëllaut » të tij Rama: « prano kushtet ose haram » Po SHBA-të dhe BE-ja?, shkruan z. Kote ne rubriken “Realpolitik” ekskluzivisht për Argumentum.al.

Shqipëria zyrtarisht ka refuzuar të dorëzojë te autoritetet turke anëtarët e lëvizjes Gulen.

Ish-ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati në vitin 2018 tha se “Shqipëria është solidarizuar me ngjarjet e ndodhura në Turqi, por se është anëtare e NATO-s dhe kandidate për BE-në dhe ndjek disa rregulla ndërkombëtare”.

Atëherë lind pyetja cila është arsyeja që sot kryeministri Rama po dorëzohet përballë kushtëzimeve të Erdogan?

Kujtojmë gjithashtu se gjatë vizitës së tij në shtetin shqiptar, më 17 janar të këtij viti, Erdogan tha se popullin turk “e lëndon thellë” fakti që në Shqipëri gjen fushëveprim, Lëvizja Hizmet.

“Sa më shpejt të shpëtoni nga kjo strukturë helmuese që përbën kërcënim për sigurinë kombëtare. Nëse nuk reagoni në kohë është e pashmangshme që tentativat që kjo strukturë realizoi në Turqi të përsëriten në Shqipëri. Ne e kemi parë dhe kemi paguar një kosto të rëndë. Ne e shohim si detyrë që të paralajmërojmë miqtë tanë. Presim që Shqipëria të marrë masa ndaj FETO dhe të mos lejojë që marrëdhëniet tona të errësohen”, tha Erdogan

para Kuvendit të Shqipërisë më 17 janar 2022.

“Nuk i kemi asnjë borxh presidentit të Turqisë dhe Turqisë, sikundër as presidenti i Turqisë dhe Republika e Turqisë nuk na kanë asnjë borxh, sepse mes miqsh dhe mes një miqësie vëllazërore nuk ka asnjë borxh.”

Kjo ishte deklarata e kryeministrit Edi Rama e dhënë për mediat pak ditë pas vizitës së presidentin të Turqisë, Recep Tayyip Erdogan në Shqipëri më 17 Janar, kur i kërkoj kreut të qeverisë shqiptare që të ndër-marrë hapa konkrete për të luftuar gjylenistët si një “parakusht” për miqësinë dhe partneritetin mes dy vendeve.

Po ashtu gjatë vizitës së Erdogan presidenti turk inauguroi mbylljen e restaurimit të Xhamisë së Et’hem Beu. Ne fakt inaugurim i kesaj xhamie qindra vjecare u shoqerua me një skandal pasi muslimanet shqiptare nuk kishin te ftuar dhe as nuk u lejuan te merrnin pjesë në këtë inagurim te Xhamisë së tyre. Sheshi” Skenderbej” u mbush me besimtare të ftuar nga xhamitë e Shkodrës dhe Shkupit. Kjo për shkak se Erdogan akuzon krerët e Komunitetit Musliman Shqiptar si gjylenistë.

Ndërsa inauguronte Xhaminë e Et’hem Beu Presidenti turk Rexhep Taip Erdogan ka konfirmuar se do të rikthehet sërish në Tiranë dhe njoftoi se xhamia e Namazgjasë do të hapet në fund të muajit të shenjtë të Ramazanit.

Në fakt muaji Maj kaloi, sërish muslimanet e festuan Ramaz-

anin në sheshin “Skenderbej”, ndërsa asnjë shenjë nuk u duk nga Erdogani.

Pikërisht mos hapja e dyerve të xhamisë së “Namazgjasë” në mes të kryeqytetit, e cila vazhdon të jetë ende e mbyllur edhe sot ishte një tjetër fakt i rëndësishëm që tregonte për një krisje të miqësisë mes Ramës dhe Erdogan.

Po ashtu edhe investimi turk i spitalit rajonal u përfol në media se Presidenti turk na e kishte bërë “haram”, madje thuhej se një pjese të stafit turk nuk iu ishte rinovuar kontrata.

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Shqipërisë, Ogerta Manastirliu, u shpreh gjatë fjalës së saj në njëvjetorin e hapjes së spitalit se duhet të konsiderohet si një vit i provës së fortë të miqësisë mes dy vendeve. “Spitali Rajonal Memorial në Fier u ndërtua falë bujarisë së presidentit Erdoğan”, thkesoi Ministrja për të zbutur kështu sadopak zemrën e Erdoganit, por një fakt i tillë nuk ndodhi as me vizitën e kryeministrit Rama në Ankara ku theksoi se ishte ftuar nga vetë Erdogan.

Në këto kushte, Kryeministri Rama duket se iu është dorëzuar plotësisht kushteve të Erdogan duke mbyllur institucione arsimore me një eksperiencë disavjeçare në vend.

Ministria e Arsimit dhe Sportit deklaroi sot se vendimi për heqjen e licencës dhe mbylljen e shkollës jopublike “Mehmet Akif Ersoy”, është rezultat i konstatimit nga MAS të një sërë shkeljeve të legjislacionit në fuqi nga zotëruesit e li-

cencës në fjalë.

Në një deklaratë për shtyp, MAS theksoi se “kanë filluar procesin mësimor 2022-2023 në një vendndodhje dhe mjedise të tjera, të pamiratuara nga MAS, pra pa certifikimin ligjor përkatës të standardeve të godinës. Nuk i kanë plotësuar më tej kriteret ligjore edhe pse nga ana MAS është kryer dy herë verifikimi i tyre dhe në kushtet e ushtrimit të veprimtarisë jashtë kriterëve përkatëse, licenca duhet të revokohet”.

Po ashtu mbyllja e kopshtit jopublik “Zubeyde Hanim” është bërë me arsyetimin e shkeljes së rëndë të licencës, pasi sipas Ministrisë së Arsimit, godina ku ushtrohej aktiviteti nuk ishte pajisur me autorizimin përkatës nga ministria.

Por deklarata e Ministres Kushi bie poshtë nga deklarata e Përfaqësuesit e “Turgut Ozal”, të cilët kanë reaguar duke kërkuar rishikimin e vendimit me argumentin se nuk kanë lidhje me fondacionin Gulen, duke bërë të qartë se e vetmja arsye e kësaj mbyllje është Fondacioni “Gulen”

Avokati tha se kopshti është financim holandez dhe se çështja do të ndiqet në rrugë ligjore.

Nuk ka lidhje mes fondacionit të Gulistan dhe shoqërisë Turgut Ozal. Aktiviteti i kopshtit është pjesë e aktiviteteve të shoqërisë Turgut Ozal, që është pjesë e një investimi të huaj holandez” tha ai.

Ndërsa Mustafa Ertekin, drejtori

i kolegjit turk ‘Mehmet Akif’ që u mbyll me vendim qeverie ka reaguar duke treguar se morën vërejtje për tabelat, llambat si dhe për mungesën e një palestere. Megjithatë tha se 3 muaj më parë bënë kërkesë për zhvendosje por nuk kanë bërë asgjë në kundërshtim me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit.

“Vërejtja që është bërë nga komisioni i inspektorëve ka qenë për 4 klasa për pozicioni i tabelës dhe mbajtja e llambës. Ndryshimin e kemi bërë menjëherë.

Ne jemi institucion arsimor 30-vjecar, e dimë si duhet të veprojmë kur zhvendosemi nga një godinë në një tjetër. Në 3 muaj kemi aplikuar në ministri për të zhvendosur godinën e re. Japim shkolim që nga viti 1992. Ky institucion i ka dhënë këtij vendi mijëra maturantë të suksesshëm, doktorë e inxhinierë. Këto vajza vijnë nga çdo krahinë e vendit dhe kanë inteligjencë e sukses.

Ne kemi vepruar sipas juridiksionit, kemi aplikuar, ka bërë vizitën por nuk na kanë thënë asgjë. Nuk kemi bërë asgjë në kundërshtim me udhëzimet e ministrisë.” tha Ertekin.

Një reagim ka ardhur dhe nga vete “Fondacioni Gulistan” i cili shpjegon se Shkolla e Mesme jopublike “Mehmet Akif” prej 26 vitesh në Shqipëri duke zbatuar në mënyrë të përpiktë kuadrin ligjor të vendit.

“Shkolla e Mesme jopublike “Mehmet Akif” është pjesë e Fondacionit “Gulistan” prej 26 vitesh në Shqipëri duke zbatuar në mënyrë të përpiktë kuadrin ligjor të vendit, ndërsa mbart mbi vete një histori të madhe

suksesi teksa është radhitur në mënyrë të vazhdueshme në krye të listës së shkollave më të mira.

Me dhjetëra medalje ari dhe qindra të tjera në olimpiada brenda dhe jashtë vendit, shkolla jonë është një krenari e nxënësve, prindërve që na besuan si edhe vetë Shqipërisë duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në rritjen e cilësisë së arsimit këtu.

Pavarësisht sukseseve tona, dashurisë dhe përkushtimit ndaj arsimit, sot u përballëm me një vendim të tillë, i cili sipas nesh nuk ka të bëjë me arsimin apo zbatimin e ligjeve të këtij vendi”, thuhet ndër të tjera në deklaratën për shtyp e “Fondacioni Gulistan” mbi VKM-në e datës 22 Shtator 2022 për mbylljen e aktivitetit të shkollës së mesme jopublike “Mehmet Akif” Tiranë

Sikundër thuhet në reagimet e përfaqësuesve ligjor dhe drejtuesve të këtyre institucioneve arsimore, Ministria e Arsimit nuk ka një arsyetim shterues mbi vendimin për mbylljen e tyre, ndaj i vetmi fakt është përndjekja e Erdogan ndaj emrit “Gulen” i cili nuk kursen as edukimin dhe shkollimin e qindra e mijëra fëmijëve shqiptarë.

Padiskutim mbyllja me një VKM e këtyre institucioneve arsimore duke mos mësuar zyrtarisht mbi shkaqet e vendimit, godet jo vetëm arsimin në Shqipëri por mbi të gjitha minon Pavarësinë e Shtetit shqiptar në marrjen e vendimeve si shtet ligor dhe demokratik e aq më tepër si një shtet anëtar i NATO-s (!)

Dear readers and followers of Argumentum.al

On the third anniversary of the founding of the online media Argumentum.al, now it comes in the version of a monthly magazine which you can browse online from April 2022.

This monthly publication offers a clear combination of news on Albania, the Western Balkans and the world, as well as opinions and analyses of events taking place during the month.

Thanking each of you for your attention and trust in our media, we promise that we will continue to publish objective analysis on key developments in the country, region, Europe and the world.

Argumentum.al strives to be an authoritative source of journalism with analyses and comments on international relations, world politics and a wide range of issues of global importance by publishing exclusive materials. This is done thanks to the contribution of some of the well-known names of Albanian politics and journalism and other local and foreign collaborators. At the same time, Argumentum.al is open for comments and opinions by its readers.

Read on domestic and international issues in the magazine Argumentum.al free of charge in Albanian and English!

“Argumentum”, an intellectual process...



Will Berisha's pledge for 'autumn of protests' deliver?



TIRANA, September 23

A “This fall will be the fall of strikes, protests, peaceful revolts, civil disobedience. This is the most fundamental condition to bring back the country to normality.” The above statement seems like a common slogan of Democratic Party (DP) which, as a matter of fact, has warned of massive anti-government protests since long time, blaming former DP head Lulezim Basha of the atrophisation of opposition. But this time DP chairman Sali Berisha said in the usual weekly press conference on Friday that the dissatisfaction and revolt is very high on the agenda and the expectation is very high. “Basha’s opposition will not be repeated. We are not at that

stage. We have to do a lot of work on strikes, protests, civil disobedience. Of course, we need organization. We will start the battle with (PM) Edi Rama and Edi Rama feels this,” he said.

Further Berisha said that he would coordinate work with the Freedom Party (FP) for the opposition action.

“No kind of rivalry exists. Meetings are held, they are public and private. I am convinced that there will be very good relations and coordination with the Freedom Party. We are on the same wavelength and we will take all the necessary steps for the success of our protests in the coming season,” said DP head. However, there is no specific details when and how the ‘autumn of protests’ will bring the overthrow of Rama government, which has hit Albanians in the hardest way after

the stratospheric increase of the energy price!

This autumn will likely be the test if this opposition has the stamina to survive on Albanian political scene or continue to become a more comfortable background of SP- led majority. DP and FP have the say in the expected struggle as the other opposition parties have turned into phantoms like the Republican Party. Besides the speedy aggravation of the economic and social situation in the country, Berisha and Meta should show their supporters and ordinary Albanians that they can face and win over the super arrogant government head, who keeps humiliating them at the extreme.

They should bring back the hope that Rama’s castle can fall opening the way to a genuine revival of Albania.

The Exhibition of Historical Sino -Albanian Photographs launched in Tirana

TIRANA, September 23

The Exhibition of Historical Sino-Albanian Photographs was launched on Tuesday at the National Historical Museum in Tirana in cooperation between the Embassy of China in Albania, the Ministry of Culture, the Municipality of Tirana within the framework of the Chinese Culture Week and the 73th anniversary of the establishment of the People's Republic of China.

The event was attended by the former President, Ilir Meta, the vice-mayor of the Municipality of Tirana, Ketil Luarasi, the former foreign minister, Arta Dade, diplomats, former ambassadors of Albania to China, the director of the "Confucius" institute in University of Tirana, researchers and citizens of Tirana.

China's ambassador to Albania, Zhou Ding, said that China and



Albania wrote together a wonderful poem of friendship in the 60s-70s of the last century. According to Ambassador Zhou, it was a period when the two peoples became closely connected and befriended each other.

The ambassador said that the photos of the exhibition focused on the precious moments of Chinese-Albanian friendship display-

ing exciting images of friendly exchanges and showed the touching story between the two peoples transcending politics and ideology.

The director of the National Historical Museum, Dorian Koçi, described as a special pleasure the opening of the photo exhibition in the frame of the Week of Chinese Culture in Tirana. According to him, many people find themselves in the presented photos during the many visits made over the years during the close Albanian-Chinese friendship, which has continued with the mutual respect between the two peoples.

"Today, China and Albania are reliable partners in all the appropriate instruments where the voice of both countries is heard. We have often had fruitful collaborations with the Embassy of China, to convey the common cultural treasures throughout all these years," said the director of the National Museum.

Spartak Nano, the head of Albania-China Friendship Association said in his speech that the ambassador of China in Albania has a special merit for promoting bilateral relations with the twinned regions.

According to him, the Week of Chinese Culture that is taking place in Tirana will serve even more for the recognition of art and culture and the further links of relations between China and Albania.

The Week of Chinese Culture will continue with other activities and will end on October 2.



Albania cuts ties with Iran over cyberattack ordering its Embassy to leave within 24 hours

TIRANA, September 7

The Council of Ministers has decided on the severance of diplomatic relations with the Islamic Republic of Iran with immediate effect.”

This was the announcement made public by Prime Minister Edi Rama who said on Wednesday that Albania broke diplomatic ties with Iran on Wednesday over an alleged cyberattack against Tirana’s government this summer, and the Iranian diplomats and embassy staff had 24 hours to leave this Balkan country.

Albania and Iran have been bitter foes for years, stemming from Tirana’s hosting of the Iranian opposition group the People’s Mujahedeen of Iran (MEK) on its soil, and the latest decision is not surprise as it comes after a string of measures taken by the Albanian government climaxing with the expulsion of the former Iranian Ambassador.

Rama accused Iran of directing a cyberattack against Albanian institutions on July 15 in a bid to “paralyse public services and hack data and electronic communications from the government systems”. It was the first time Tirana spoke about the alleged attack, and Rama said his country cut ties with Iran over it. “The said attack failed its purpose. Damages may be considered minimal compared



to the goals of the aggressor. All systems came back fully operational and there was no irreversible wiping of data,” said the government head. “This extreme response ... is fully proportionate to the gravity and risk of the cyberattack that threatened to paralyse public services, erase digital systems and hack into state records, steal government intranet electronic communication and stir chaos and insecurity in the country.”

Following the announcement, the United States lambasted Iran for the alleged cyberattack, vowing to provide support to its ally in the Balkans. “The United States strongly condemns Iran’s cyberattack against our NATO ally, Albania,” National Security Council spokeswoman Adrienne Watson said in a statement quoted by local and foreign news agencies. “The United States will take further action to hold Iran accountable for actions that threaten the security of a US ally and set a troubling precedent for

cyberspace,” Watson added. Albania agreed in 2013 to take in members of the exiled group at the request of Washington and the United Nations, with thousands settling in the Balkan country over the years.

Following the collapse of its communist government in the early 1990s, Albania has transformed into a steadfast ally of the United States and the West, officially joining NATO in 2009.

The MEK backed Ayatollah Ruhollah Khomeini in the 1979 revolution that ousted the shah but rapidly fell out with the new Islamic authorities and embarked on a decades-long campaign to overthrow the regime.

The MEK regularly hosts summits in Albania that have long attracted support from conservative US Republicans, including former vice president Mike Pence who delivered a keynote address at an event in June. A month later, the group postponed another summit citing unspecified security threats targeting the event. The summit was called off “upon recommendations by the Albanian government, for security reasons, and due to terrorist threats and conspiracies”, the MEK said in a statement released in late July.

The gathering was supposed to be attended by or joined online by various high-profile political delegations, including hundreds of lawmakers from six conti-

nents, organisers said.

Iranian opposition groups in exile have accused Tehran of targeting their events and personnel for years. The MEK, which has been based in Albania since 2013, is regarded as a terrorist organisation in Iran and has long sought the overthrow of the Islamic Republic.

Designated a terrorist organisation by the US in 1997, the MEK was removed from the ter-

ror list in 2012 and now counts numerous American politicians – mainly those opposed to Iran – among its supporters.

In 2018, Belgian police thwarted a terrorist attack that was supposed to target an Iranian opposition rally outside Paris, after which an Iranian diplomat was convicted for supplying explosives for the plot. Albania has expelled a string of Iranian diplomats from the Balkan country over the years,

including Tehran's ambassador to the country in December 2018. Though there has been no official response from Iran, the Fars News Agency – a news outlet close to the Islamic Revolutionary Guard Corps – reported on the news, referring to Albania's support for the “hypocrites” of the MEK.

The move to cut ties with Iran was also praised by the opposition political forces, some of whose leaders said it was a delayed action.



Queen Elizabeth dies at 96, ending an era for Britain

and the Queen Consort will remain at Balmoral this evening and will return to London tomorrow.”

The royal family's official website carried the message: “Queen Elizabeth II 1926-2022” along with the official statement issued by Buckingham Palace.

In statement, the new king said: “The death of my beloved mother, Her Majesty The Queen, is a moment of the greatest sadness for me and all members of my family. “We mourn profoundly the passing of a cherished sovereign and a much-loved mother. I know her loss will be deeply felt throughout the country, the realms and the Commonwealth, and by countless people around the world.

“During this period of mourning and change, my family and I will be comforted and sustained by our knowledge of the respect and deep affection in which the Queen was so widely held.”

Flags on landmark buildings in Britain were being lowered to half mast as a period of official mourning was announced. Royal residences that are open to the public will be closed.

Prime Minister Liz Truss, who was appointed by the Queen on Tuesday, said the monarch “provided us with the stability and strength that we needed”. She said His Majesty would be known as King Charles III.

Q

ueen Elizabeth II, the longest-reigning monarch in British history, has died at the age of 96.

Prince Charles, 73, heir to the throne since the age of three, is now king, and the Duchess of Cornwall is now Queen Consort.

In a statement, Buckingham Palace said: “The Queen died peacefully at Balmoral this afternoon. The King

Berlin is more than enough! Erdogan, conditions otherwise Haram! Good words but stones in the rafters! The dialogue is Vucic hostage!!

REALPOLITIK "FLASH" NO. 30 | 1 – 15 SEPTEMBER 2022

EXCLUSIVELY at ARGUMENTUM, "Grand Master", DR. JORGJI KOTE, "dots the i's and crosses the t's" on 4 major events in only 1000 words!



DR. JORGJI KOTE

1. Berlin is more than enough!

This was clearly shown by the "Open Balkans" Summit on 2 September, in the context of the "Food Fair" in Belgrade (1 – 4 September). However, despite the wine flavour, the glamour and pump, it marked its biggest political – diplomatic failure.

Apart from the permanent sponsor, Alex Soros, no other senior guests were there from the EU, its Czech Presidency

and the USA. No personal message from them, as before. Italy and Greece declined the invitation for the second time; it's normal, since Italy is involved in "Berlin Process", on which recently, Greece has also shown interest. I do not know how consoling was the presence of the chief diplomats from Ankara and Budapest, both not in the Berlin Process or the presence of Zaev and Abazovic, "fallen from the fig of power" Ironically enough, the taste of wine and the political humor of senior

guests in Belgrade was spoiled by the disquietening reports/polls by the US prestigious foundation « Rockefeller », Euroactiv, and internationally recognized German and US experts. Besides, the Albanian unprecedented arbitrariness and state violence in the "Prestige Resort" overshadowed this event. Par consequence, the regional and international echo was Nil.

The alarming problem is that the "Open Balkan" leaders, Vucic, Rama and Kovacevski do not want to see that even this



summit in Belgrade would have been much more successful and all – inclusive if it was organized under “Berlin Process” and the EU Regional Common Market. There would be the 6 countries of the region and at last 6 times more participating companies! Plus, personalities from Washington, Brussels, Berlin, Paris, Rome, London and Prague, which holds the EU Presidency and others. But the damaging defiance towards Brussels and Berlin has made those “captured” by Open Balkans blind; so they cannot see beyond Belgrade, Tirana and Skopje! Let us hope that until 3 November, when the Berlin Process will resume, they will finally realize that Berlin and Brussels are more than enough for us, so, enough is enough with “Open Balkans”!

2. Erdogan: conditions, otherwise Haram! Following the previous “ice – cold” meeting in Ankara between Erdogan and Rama, Turkey gave two other testimonies of their political bad feelings with official Tirana. A few weeks ago, the Turkish Foreign Minister, Mr. Cavutoğlu was on a regional tour, but he avoided Tirana. Neither did he meet PM Rama in the “Open Balkans” Summit in Belgrade. Meanwhile, from 7 – 9 September, President Erdogan was also

in a tour in the region, but again he “forgot” Tirana. Although he had promised to be there this May. There are other hints and indications, which show that Tirana should satisfy the Ankara demands related to gylenists and Moslem Community in order to restore the good political mood of the Turkish friends. In a word, Erdogan is indirectly

A few weeks ago, the Turkish Foreign Minister, Mr. Cavutoğlu was on a regional tour, but he avoided Tirana. Neither did he meet PM Rama in the “Open Balkans” Summit in Belgrade. Meanwhile, from 7 – 9 September, President Erdogan was also in a tour in the region, but again he “forgot” Tirana. Although he had promised to be there this May.

telling to his “brother” Rama: “accept the conditions or Haram” But what about USA and EU?

3. Good words but stones in the rafters”! This aphorism comes to mind after the Balkans Summit in Brdo on 12 September. In fact, it was an extension of the Balkans “Summer Theatre of Summits”! Everything there was painted in rose, as if there is no problem in Western Balkans apart from the visa liberalization for Kosovo and acceleration of the enlargement process to WB, both tasks for the EU. Although this message is repeated over and over again and has become boring. Under the sunny summer atmosphere in Brdo, the 6 WB leaders enjoyed the flavour of the delicious Slovenian&Croatian wines and delicacies, away from noise and media, applying the principle: “Never mention rope in the house of the man who has been hanged”» Therefore, there was hardly any word on the dialogue between Pristine and Belgrade, which is in a real blind alley, the political crisis in Montenegro, in Bosnia, problems among the countries of the region, energy crisis and even “Open Balkans” since PM Rama was absent. As our saying goes, there were there only “good words but stones in the rafters” Actual-

“Never mention rope in the house of the man who has been hanged”»
Therefore, there was hardly any word on the dialogue between Pristina and Belgrade, which is in a real blind alley, the political crisis in Montenegro, in Bosnia, problems among the countries of the region, energy crisis and even “Open Balkans” since PM Rama was absent.



ly, these summits have become like mushrooms, both in summer and now in autumn; thus, Brdo Summit followed those in Thessaloniki, Belgrade, Ohrid, Alpbach in Austria.... Perhaps it is high time to reduce or discontinue them, since apart from talk&eating, the time spent and superload of relevant agencies,

there is nothing useful “on the bags” of participants; no coming closer but drifting apart, no friendship but hostility, as the case with Vucic who once in Belgrade swore not to recognize Kosovo! On the other hand, he keeps inviting Kosovo to join Open Balkans!! What a hypocrisy! In this case, even the large

expenses for such summits that have become boring shows may be used for cultural festivals, youth and other events.

4.The dialogue is Vucic Hostage! This was clearly seen on 13 September during the speech by President Vucic in the plenary session of the Serbian parliament, which lasted 25 hours! He solemnly declared that there would be no recognition of Kosovo, that Belgrade will step up the withdrawal of other state recognitions and that they are prepared even for an armed conflict, since Serbia is 10 times stronger now than in 1999! This statement came just a few days after the highest diplomatic envoyées of President Macron and Chancellor Scholz met with PM Kurti and President Vucic, in an effort to boost the dialogue; pressing Vucic to urgently recognize Kosovo’s independence. President Vucic considered this as a “new dialogue frame from the west” but there is nothing new in that except the growing pressure on Serbia. Meanwhile the “geography” of international mediation continues to expand. Slovenia has recently appointed a mediator, who joins those of EU, the USA, France, Germany and the UK. Let us hope that the wise saying “too many cooks spoil the broth” would not come true this time! But the bitter fact is that this dialogue is captured and held hostage by Serbia and President Vucic; hence, any attempt and effort could be futile if Belgrade does not set free this “hostage”, i.e. its dialogue with Pristina! For, as we say in Albania” pilaf cannot hold any more water” and “the cup is full”!





Adresa: Njësia bashkiake nr. 5, Rruga “Abdyl Frasheri”, Ndërtesa 8, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (0) 68 82 01 720

Email: redaksia.argumentum@gmail.com,
info@argumentum.al

Marketing & PR

Email: marketing@argumentum.al

Tel: +355 (0) 68 82 01 720

NUIS/NIPT: L91415033Q

...

Twiter : [Argumentum_al](https://twitter.com/Argumentum_al)

Facebook: [argumentum.al](https://www.facebook.com/argumentum.al)

Instagram: [argumentumnews](https://www.instagram.com/argumentumnews)